



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MIRËMBAJTJES SË OBJEKTEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2026

PROCESVERBAL

Tipi i kontratës – Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROCEDURËS: "Mirëmbajtje e zakonshme e ndërtesave sociale"

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 50800000-3 –
Shërbime të ndryshme riparimi dhe mirëmbajtjeje**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 3,874,779.60 (tre milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e
shtatëqind e shtatëdhjetë e nëntë presje gjashtëdhjetë) lekë pa TVSH.**

Në mbështetje të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, nenit 2, pika 2, shkronja "c", dhe nenit 78, pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Mirëmbajtjes së Objekteve Publike, Bashkia Shkodër, harton këtë procesverbal për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të kualifikimit për procedurën e prokurimit "Procedurë e hapur e thjeshtuar", me objekt: "Mirëmbajtje e zakonshme e ndërtesave sociale".

Specifikimet teknike dhe kriteret e veçanta të kualifikimit janë hartuar në përputhje me natyrën, objektin, vlerën dhe kompleksitetin e kontratës, mbi bazën e kërkesave të njësisë kërkuese, termave të referencës, preventivit, specifikimeve teknike, grafikut të realizimit të shërbimeve dhe fondit limit të miratuar.

Në hartimin e tyre janë respektuar parimet themelore të prokurimit publik, të parashikuara në Ligjin nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, konkretisht parimi i transparencës, trajtimit të barabartë dhe jodiskriminues të operatorëve ekonomikë, proporcionalitetit, konkurrencës efektive dhe përdorimit me efektivitet të fondeve publike.

Kriteret e veçanta të kualifikimit janë përcaktuar në mënyrë të tillë që të jenë të lidhura ngushtë dhe në përpjesëtim me objektin e kontratës, duke mos krijuar kufizime të pajustificuara për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe duke garantuar një konkurrencë sa më të gjerë.

Specifikimet teknike janë hartuar në mënyrë të qartë, të plotë dhe jodiskriminuese, duke përshkruar kërkesat funksionale dhe teknike të nevojshme për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, pa favorizuar apo kufizuar pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë të caktuar dhe në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

Përcaktimi i kriterëve të kualifikimit synon të garantojë që operatori ekonomik fitues të disponojë kapacitetin ligjor, profesional, ekonomik, financiar dhe teknik të nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës, sipas standardeve të kërkuara të cilësisë, brenda afateve të përcaktuara dhe në përputhje me specifikimet teknike, termat e referencës dhe legjislacionin në fuqi.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;
- b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar në mbështetje të:

- nenit 76 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, lidhur me shkaqet e skualifikimit;
- nenit 82 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, që parashikon përdorimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit si provë paraprake për përmbushjen e kriterëve të kualifikimit;
- nenit 83 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, që rregullon sigurimin e ofertës;
- nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar;
- nenit 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar;
- Dokumenteve Standarde të Tenderit për procedurën "Procedurë e hapur e thjeshtuar – Shërbime".

Paraqitja e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe Sigurimit të Ofertës është kërkuar për të garantuar përmbushjen e kërkesave ligjore të procedurës së prokurimit, seriozitetin e ofertës dhe mbrojtjen e interesit të Autoritetit Kontraktor gjatë zhvillimit të procedurës.

Shënim:

Për të gjitha kriteret e veçanta të kualifikimit, përmbushja e tyre vetëdeklarohet nëpërmjet Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Dokumenteve Standarde të Tenderit, kur kjo është e aplikueshme. Dokumentacioni provues paraqitet vetëm nga operatori ekonomik i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit ose kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor, në përputhje me Ligjin nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për

miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, dhe Dokumentet Standarde të Tenderit.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 9 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 1, shkronja "a" dhe pika 2, si dhe nenit 82 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, në lidhje me nenin 26 dhe nenin 41, pika 4, shkronja "a", të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar.

Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor verifikon se operatori ekonomik është i autorizuar ligjërisht për të ushtruar veprimtarinë profesionale që lidhet me objektin e kontratës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kërkesa është në përputhje me natyrën, objektin, vlerën dhe kompleksitetin e kontratës "Mirëmbajtje e zakonshme e ndërtesave sociale", nuk krijon kufizime të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe garanton respektimin e parimeve të transparencës, proporcionalitetit, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit, në përputhje me legjislacionin për prokurimin publik.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar

2.2.1 Për të provuar kapacitetin ekonomik dhe financiar, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023, 2024 dhe 2025**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **40% e vlerës së përllogaritur të kontratës**, konkretisht **1,550,000.00 (një milion e pesëqind e pesëdhjetë mijë) lekë pa TVSH**.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatori ekonomik arrin vlerën minimale të xhiros në të paktën **një (1)** nga vitet financiare të kërkuara.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 3, të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 43, pika 2, në lidhje me nenin 55, pika 4, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar.

Në zbatim të dispozitave të mësipërme, Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë dokumentacion që provon kapacitetin ekonomik dhe financiar të operatorëve ekonomikë, me qëllim garantimin se ata disponojnë burimet financiare të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

Duke qenë se procedura e prokurimit është "**Procedurë e hapur e thjeshtuar**", vlera minimale e xhiros është përcaktuar në masën **40% të vlerës së përlogaritur të kontratës**, në përputhje me kufirin maksimal të lejuar nga neni 55, pika 4, i VKM nr. 285/2021.

Kërkesa është në përpjesëtim me natyrën, objektin, kompleksitetin, kohëzgjatjen dhe vlerën e kontratës dhe nuk krijon kufizime të pajustificuara për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, duke garantuar respektimin e parimit të proporcionalitetit dhe konkurrencës efektive.

Përcaktimi i viteve financiare **2023, 2024 dhe 2025** është bërë duke marrë në konsideratë periudhën më të fundit të raportimit financiar të përfunduar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, me qëllim verifikimin e kapacitetit ekonomik dhe financiar të operatorëve ekonomikë mbi bazën e të dhënave financiare zyrtare.

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të ketë përmbushur detyrimet për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për vitin **2025**, si dhe këstet e maturuara të vitit **2026**, për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore ku ushtron aktivitet, sipas të dhënave të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), në përputhje me afatet e pagesës të përcaktuara nga secila njësi e vetëqeverisjes vendore.

Dokumentacioni provues do të paraqitet vetëm nga operatori ekonomik i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit ose kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor, dhe duhet të vërtetojë përmbushjen e detyrimeve për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron aktivitet sipas të dhënave të regjistruara në QKB.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 3, dhe nenit 82 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 26 dhe nenit 43, pika 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar.

Kërkesa synon të verifikojë se operatori ekonomik ka përmbushur detyrimet për pagesën e taksave dhe tarifave vendore për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore ku ushtron aktivitet, sipas të dhënave të regjistruara në QKB, duke garantuar se ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin fiskal në fuqi.

Përcaktimi i vitit **2025** dhe i kësteve të maturuara të vitit **2026** është bërë në përputhje me Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore", i ndryshuar, si dhe me afatet e pagesës të miratuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke mos kërkuar shlyerjen e detyrimeve që nuk kanë arritur ende afatin ligjor të pagesës.

Kërkesa është në përpjesëtim me objektin, natyrën dhe vlerën e kontratës, garanton trajtim të barabartë të operatorëve ekonomikë dhe mundëson verifikimin e rregullsisë së tyre fiskale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2.3 Kapaciteti teknik

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbime të mëparshme të ngjashme, të realizuara gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e publikimit të njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës, konkretisht 775,000.00 (shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë pa TVSH.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dokumentacionin e mëposhtëm:

- a)** Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose/dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b)** Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 41, pika 3 dhe nenit 55, pika 4, shkronja "b", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar.

Në përputhje me nenin 41, pika 3, të VKM nr. 285/2021, autoriteti kontraktor mund të kërkojë nga operatorët ekonomikë dokumentacion që provon aftësinë teknike dhe profesionale, në masën e nevojshme dhe në përpjesëtim me objektin e kontratës.

Gjithashtu, në procedurën e hapur të thjeshtuar, sipas nenit 55, pika 4, shkronja "b", autoriteti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të provojnë përvojën e mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, të realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e publikimit të njoftimit të kontratës.

Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor synon të verifikojë se operatori ekonomik disponon përvojën e nevojshme teknike dhe profesionale për realizimin e shërbimeve objekt prokurimi, sipas standardeve të kërkuara të cilësisë dhe brenda afateve të përcaktuara në kontratë.

Vlera e kërkuar prej 20%, konkretisht 775,000.00 (shtatëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë pa TVSH, është përcaktuar në përputhje me kufirin maksimal të lejuar nga legjislacioni në fuqi dhe është në raport të drejtë me natyrën, kompleksitetin, vëllimin dhe vlerën e kontratës. Kjo kërkesë

respekton parimin e proporcionalitetit, garanton konkurrencë efektive dhe nuk krijon kufizime të pajustificuara për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

2.3.2 Licenca për zbatimin e punimeve të ndërtimit

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me **licencë për zbatimin e punimeve të ndërtimit**, të lëshuar nga autoriteti kompetent, e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- **N.P – 1 Niveli A** Punime gërmimi në tokë;
- **N.P – 2 Niveli A** Ndërtime civile dhe industriale;
- **N.S – 2 Niveli A** Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre;
- **N.S – 14, Niveli A** Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni, televizion etj.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, nenit 41, pika 4, shkronja "a", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar, si dhe të Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar si dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor synon të verifikojë se operatorët ekonomikë disponojnë licencën e nevojshme për zbatimin e punimeve që përfshihen në objektin e kontratës dhe janë të autorizuar ligjërisht për realizimin e tyre.

Objekti i kontratës "Mirëmbajtje e zakonshme e ndërtesave sociale" përfshin punime të karakterit ndërtimor, punime gërmimi, punime hidroizolimi, shtresa betoni dhe çakëlli, veshje me pllaka, punime në impiantet hidro-sanitare, si dhe punime në impiantet elektrike. Për këtë arsye, është vlerësuar e domosdoshme kërkesa për licencë në kategoritë përkatëse, të cilat mbulojnë të gjitha punimet e parashikuara në preventiv dhe në specifikimet teknike.

Kategoritë e licencës janë përcaktuar pas analizës së preventivit, specifikimeve teknike dhe zërave të punimeve, duke siguruar që secila kategori të ketë lidhje të drejtpërdrejtë me punimet që do të realizohen gjatë ekzekutimit të kontratës.

Në mënyrë konkrete:

- **N.P-1** është kërkuar për realizimin e punimeve të gërmimit dhe sistemimit të terrenit;
- **N.P-2** është kërkuar për realizimin e punimeve civile dhe ndërtimore, përfshirë prishje, hidroizolim, shtresa betoni, shtresa çakëlli, ulluqe, veshje me pllaka dhe punime të tjera ndërtimore;
- **N.S-2** është kërkuar për realizimin e punimeve në impiantet hidro-sanitare, përfshirë tubacionet e kanalizimeve, tubacionet e ujësjellësit dhe pajisjet hidro-sanitare;
- **N.S-14** është kërkuar për realizimin e punimeve në impiantet elektrike, konkretisht furnizimin dhe montimin e pajisjeve elektrike të parashikuara në preventiv.

Kërkimi i kategorisë **N.S-14, Niveli A** është në përputhje me natyrën dhe vëllimin e punimeve elektrike objekt kontrate. Kategoritë e tjera të licencës janë kërkuar në masën e nevojshme për realizimin e punimeve të parashikuara në preventiv, pa vendosur kërkesa më të larta se ato që justifikohen nga objekti i kontratës.

Kërkesa është në përputhje me objektin, natyrën, kompleksitetin dhe vlerën e kontratës, respekton parimin e proporcionalitetit dhe nuk krijon kufizime të pajustificuara për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, duke garantuar njëkohësisht që operatori ekonomik fitues të disponojë kapacitetin teknik dhe autorizimin ligjor për realizimin e kontratës.

Lidhja ndërmjet kategorive të licencës dhe zërave përkatës të preventivit paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Kategoria e kërkuar	Përshkrimi sipas legjislacionit	Zërat e preventivit	Niveli
N.P – 1	Punime gërmimi në tokë	3.17	A
N.P – 2	Ndërtime civile dhe industriale	2.281; 2.197/1; 2.37/5a; 2.197; 2.209; 2.212; 2.267/a; 2.262/4; 3.207/1; 2.196/c; 2.267/b	A
N.S – 2	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre	2.52; 2.515; 2.491/c	A
N.S – 14	Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni, televizion etj.	2.535	A

2.3.3 Personeli teknik

Operatori ekonomik duhet të disponojë personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës, si më poshtë:

- **1 (një) Inxhinier Ndërtimi**, i cili duhet:
 - të jetë i punësuar me kohë të plotë pranë operatorit ekonomik;
 - të figurojë në listëpagesat e shoqërisë (E-Sig) për të paktën muajin e fundit përpara datës së publikimit të njoftimit të kontratës;
 - të jetë i përfshirë si **Drejtues Teknik** në licencën për zbatimin e punimeve të ndërtimit të operatorit ekonomik.

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë të nënshkruar nga administratori i shoqërisë, nëpërmjet së cilës:

- përcakton Inxhinierin e Ndërtimit si Drejtues Teknik për realizimin e kontratës;

- deklaron se Drejtuesi Teknik do të jetë i disponueshëm gjatë gjithë periudhës së zbatimit të kontratës.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Dokumentacioni provues do të paraqitet vetëm nga operatori ekonomik i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit ose kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor, dhe duhet të përfshijë:

- *Diplomën e Inxhinierit të Ndërtimit;*
- *Kontratën individuale të punës;*
- *Dokumentacionin që provon regjistrimin në listëpagesat E-Sig për muajin e fundit;*
- *Deklaratën e administratorit për përcaktimin dhe disponueshmërinë e Drejtuesit Teknik.*

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, dhe nenit 82 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 26 dhe nenit 41, pika 4, shkronja "b", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar.

Kërkesa është gjithashtu në përputhje me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, sipas të cilit punimet e ndërtimit realizohen nga subjekte të pajisura me licencën përkatëse dhe nën drejtimin teknik të personave përgjegjës për zbatimin e tyre.

Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor synon të verifikojë se operatori ekonomik disponon personelin teknik të nevojshëm dhe të kualifikuar për organizimin, drejtimin dhe kontrollin teknik të punimeve objekt kontrate.

Kërkesa për 1 (një) Inxhinier Ndërtimi, i cili njëkohësisht do të ushtrojë funksionin e Drejtuesit Teknik, është vendosur duke marrë në konsideratë natyrën, kompleksitetin dhe vëllimin e punimeve të parashikuara në preventiv dhe specifikimet teknike. Punimet objekt kontrate përfshijnë punime gërmimi, punime civile, hidroizolim, sistemim oborri, punime në impiantet hidro-sanitare dhe elektrike, të cilat kërkojnë drejtim dhe mbikëqyrje të vazhdueshme teknike.

Drejtuesi Teknik është përgjegjës për organizimin e punimeve, ndjekjen e zbatimit të projektit dhe specifikimeve teknike, kontrollin e cilësisë së materialeve dhe punimeve, si dhe respektimin e kërkesave teknike dhe ligjore gjatë realizimit të kontratës.

Kërkesa që Inxhinieri i Ndërtimit të jetë i përfshirë si Drejtues Teknik në licencën për zbatimin e punimeve të ndërtimit garanton që operatori ekonomik disponon personin përgjegjës teknik të autorizuar për kategoritë e licencës së kërkuar dhe që ai do të ushtrojë funksionet e tij gjatë zbatimit të kontratës.

Kërkesa për deklarimin e disponueshmërisë së Drejtuesit Teknik është vendosur në përputhje me Rekomandimin nr. 6732, datë 21.10.2020, të Agjencisë së Prokurimit Publik, mbi problematikat e konstatuara gjatë monitorimit të procedurave të prokurimit publik, me qëllim garantimin që personeli teknik i deklaruar do të jetë realisht në dispozicion për realizimin e kontratës gjatë gjithë periudhës së zbatimit të saj.

Në zbatim të nenit 82 të Ligjit nr. 162/2020 dhe nenit 26 të VKM nr. 285/2021, përmbushja e këtij kriteri vetëdeklarohet në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues paraqitet vetëm nga operatori ekonomik i renditur i pari ose kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor.

Kërkesa është në përputhje me objektin, natyrën, kompleksitetin dhe vlerën e kontratës, respekton parimin e proporcionalitetit dhe nuk krijon kufizime të pajustificuara për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, duke garantuar njëkohësisht realizimin cilësor dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi të kontratës objekt prokurimi.

2.3.4 Personeli teknik dhe fuqia punëtore

Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë personelin teknik dhe fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin e kontratës.

Numri mesatar i punonjësve të siguruar për muajin e fundit, përpara datës së publikimit të njoftimit të kontratës, duhet të jetë jo më pak se **12 (dymbëdhjetë) punonjës**, të organizuar minimalisht sipas profileve të mëposhtme:

Profili	Numri minimal
Punëtor ndërtimi	6
Elektricitist	1
Hidraulik	1
Punëtor i pakualifikuar	4
Totali	12

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit ose kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor, duhet të paraqesë dokumentacionin provues si më poshtë:

a) Për numrin mesatar të punonjësve:

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ose dokument ekuivalent që provon numrin mesatar të punonjësve të siguruar;
- Listëpagesat E-Sig për muajin e fundit.

b) Për punëtorët e ndërtimit, elektrikistin dhe hidraulikun:

- Kontratën individuale të punës;
- Diplomë, certifikatë ose dëshmi kualifikimi profesional të lëshuar nga institucione arsimore, qendra të formimit profesional ose institucione të autorizuar/licencuara sipas legjislacionit në fuqi;
- Dokumentacion që provon regjistrimin në listëpagesat E-Sig për muajin e fundit.

c) Për punëtorët e pakualifikuar:

- Kontratën individuale të punës;
- Dokumentacion që provon regjistrimin në listëpagesat E-Sig për muajin e fundit.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, dhe nenit 82 të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 26 dhe nenit 41, pika 4, shkronjat "b" dhe "c", të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar.

Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor synon të verifikojë se operatori ekonomik disponon personelin teknik të kualifikuar dhe fuqinë punëtore të nevojshme për realizimin e kontratës, në përputhje me natyrën, kompleksitetin, vëllimin e punimeve dhe afatin e zbatimit të saj.

Në zbatim të nenit 82 të Ligjit nr.162/2020 dhe nenit 26 të VKM nr.285/2021, përmbushja e këtij kriteri vetëdeklarohet në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues paraqitet vetëm nga operatori ekonomik i renditur i pari ose kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor.

Numri minimal prej **12 (dymbëdhjetë) punonjësish** është përcaktuar mbi bazën e analizës së preventivit, specifikimeve teknike, grafikut të realizimit të punimeve, afatit kontraktor prej **1 (një) muaji**, si dhe normativave të punës sipas Manualit Teknik të Ndërtimit.

Përllogaritja e nevojës minimale për personel është kryer duke marrë në konsideratë orët e punës të parashikuara në preventiv, kohëzgjatjen e kontratës dhe fondin kohor të punës prej **8 (tetë) orësh në ditë dhe 22 (njëzet e dy) ditësh pune në muaj**, sipas formulës:

Numri i punonjësve = Orët totale të punës ÷ (8 orë/ditë × 22 ditë pune).

Nga analiza teknike rezulton:

- **Punime elektrike:** Totali i orëve të punës sipas preventivit është **1 orë**.

Përllogaritja: $1 \div (8 \times 22) = 0.0057$ punonjës.

Megjithëse rezultati matematikor është më i vogël se një punonjës, punimet elektrike duhet të realizohen nga personel i specializuar. Për këtë arsye është kërkuar minimalisht **1 (një) elektrikist**.

- **Punime hidro-sanitare:** Totali i orëve të punës sipas preventivit është **21.10 orë**.

Përllogaritja: $21.10 \div (8 \times 22) = 0.1199$ punonjës.

Duke qenë se punimet hidro-sanitare kërkojnë personel të kualifikuar, është kërkuar minimalisht **1 (një) hidraulik**.

- **Punime ndërtimore:** Totali i orëve të punës sipas preventivit është **1039.13 orë**.

Përllogaritja: $1039.13 \div (8 \times 22) = 5.9041$ punonjës.

Duke rumbullakosur rezultatin në numrin e plotë më të afërt sipër, rezulton nevoja për **6 (gjashtë) punëtorë ndërtimi**, të cilët do të realizojnë punimet civile, hidroizolimin, shtresat e betonit, shtresat e çakëllit, shtrimin e pllakave dhe punimet e tjera ndërtimore.

- **Punëtorë të pakualifikuar:** Totali i orëve të punës sipas preventivit është **651.74 orë**.

Përllogaritja: $651.74 \div (8 \times 22) = 3.7031$ punonjës.

Duke rumbullakosur rezultatin në numrin e plotë më të afërt sipër, rezulton nevoja për **4 (katër) punëtorë të pakualifikuar**, të cilët do të angazhohen në transportin manual të materialeve, sistemimin dhe pastrimin e ambienteve të punës, si dhe në punët ndihmëse gjatë realizimit të kontratës.

Bazuar në analizën e mësipërme, rezulton se struktura minimale e personelit për realizimin e kontratës është:

Profili	Numri minimal
Punëtor ndërtimi	6
Elektricitist	1
Hidraulik	1
Punëtor i pakualifikuar	4

Ky numër është minimumi i nevojshëm për realizimin e kontratës brenda afatit prej **1 (një) muaji**, duke garantuar zhvillimin paralel të proceseve të punës, respektimin e grafikut të punimeve, specifikimeve teknike dhe standardeve të cilësisë.

Kërkesa është në përpjesëtim me natyrën, objektin, vëllimin, kompleksitetin, afatin dhe vlerën e kontratës, respekton parimin e proporcionalitetit dhe nuk krijon kufizime të pajustificuara për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, duke garantuar që operatori ekonomik fitues të disponojë kapacitetin organizativ dhe burimet njerëzore të nevojshme për realizimin me sukses të kontratës.

2.3.5 Mjetet dhe pajisjet teknike

Operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë minimalisht mjetet dhe pajisjet e mëposhtme për realizimin e kontratës:

Nr.	Mjeti/Pajisja	Sasia minimale
1	Mjet transporti vetëshkarkues deri në 5 ton	1 copë
2	Grejder	1 copë
3	Rul me vibrim	1 copë
4	Elektro argano	1 copë
5	Mjete të ndihmës së shpejtë (Kuti e ndihmës së parë)	1 set

Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10 të Dokumenteve Standarde të Tenderit.

Operatori ekonomik i renditur i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit ose kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor, duhet të paraqesë dokumentacionin provues si më poshtë:

Për mjetet që regjistrohen në regjistrat publikë:

- Lejen e qarkullimit;
- Certifikatën e kontrollit teknik, kur është e aplikueshme;
- Policën e sigurimit të vlefshme;
- Certifikatën për transport mallrash brenda vendit, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi.

Për mjetet që nuk regjistrohen në regjistrat publikë:

- Dokument që provon pronësinë e tyre (faturë tatimore blerjeje, akt zhdoganimi ose dokument tjetër i vlefshëm sipas legjislacionit në fuqi).

Për mjetet e marra me qira:

- Kontratën e qirasë, të vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës;
- Për mjetet që regjistrohen në regjistrat publikë, lejen e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik, policën e sigurimit dhe certifikatën për transport mallrash brenda vendit, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi;
- Për mjetet që nuk regjistrohen në regjistrat publikë, dokumentacionin që provon pronësinë e tyre.

Argumentimi

Ky kriter është përcaktuar në mbështetje të nenit 77, pika 4, dhe nenit 82 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 26 dhe nenit 41, pika 4, shkronja "ç", të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar.

Nëpërmjet këtij kriteri, Autoriteti Kontraktor verifikon se operatori ekonomik disponon mjetet dhe pajisjet teknike të nevojshme për realizimin e kontratës, të cilat mund të jenë në pronësi ose të marra me qira, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në zbatim të nenit 82 të Ligjit nr. 162/2020 dhe nenit 26 të VKM nr. 285/2021, përmbushja e këtij kriteri vetëdeklarohet në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, ndërsa dokumentacioni provues paraqitet vetëm nga operatori ekonomik i renditur i pari ose kur kërkohet nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i llojit dhe numrit të mjeteve është bërë mbi bazën e analizës së preventivit, specifikimeve teknike, grafikut të realizimit të punimeve dhe afatit të zbatimit të kontratës, duke marrë në konsideratë nevojat reale për realizimin e punimeve objekt prokurimi.

Konkretisht:

- **1 (një) mjet transporti vetëshkarkues deri në 5 ton** kërkohet për transportin e materialeve të ndërtimit, largimin e mbetjeve inerte dhe furnizimin e vazhdueshëm të objektit me materiale ndërtimore.
- **1 (një) grejder** kërkohet për sistemimin dhe profilizimin e terrenit, në përputhje me zërat përkatës të preventivit.
- **1 (një) rul me vibrim** kërkohet për ngjeshjen e shtresave të çakëllit dhe bazamenteve, sipas specifikimeve teknike dhe preventivit.
- **1 (një) elektro argano** kërkohet për ngritjen dhe transportimin vertikal të materialeve dhe pajisjeve gjatë realizimit të punimeve, duke garantuar zhvillimin e sigurt dhe efikas të proceseve të punës.
- **1 (një) set mjeteesh të ndihmës së shpejtë (kuti e ndihmës së parë)** kërkohet për garantimin e kushteve minimale të sigurisë dhe ndërhyrjes së menjëhershme në rast aksidenti gjatë realizimit të punimeve, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Numri i mjeteve dhe pajisjeve është përcaktuar si minimumi i nevojshëm për realizimin e kontratës, duke marrë në konsideratë natyrën, vëllimin, kompleksitetin dhe afatin e realizimit të punimeve. Kërkesa është në përpjesëtim me objektin dhe vlerën e kontratës, respekton parimin e proporcionalitetit dhe nuk krijon kufizime të pajustificuara për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, duke garantuar që operatori ekonomik fitues të disponojë kapacitetin teknik të nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës.

II. Argumentimi i Specifikimeve Teknike

Specifikimet teknike janë hartuar në mbështetje të nenit 4, pika 38/b, nenit 36 dhe nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, si dhe nenit 40, pika 2, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar.

Specifikimet teknike janë përgatitur mbi bazën e nevojave reale të Autoritetit Kontraktor, duke u mbështetur në preventivin, termat e referencës, gjendjen ekzistuese të objekteve sociale dhe ndërhyrjet e parashikuara për realizimin e kontratës "Mirëmbajtje e zakonshme e ndërtesave sociale".

Përcaktimi i tyre është bërë në mënyrë që të garantojë realizimin e punimeve sipas standardeve të kërkuara të cilësisë, funksionalitetit, qëndrueshmërisë, sigurisë dhe jetëgjatësisë, duke respektuar njëkohësisht parimet e proporcionalitetit, trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe konkurrencës efektive, të parashikuara në legjislacionin për prokurimin publik.

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me zërat e preventivit dhe me kërkesat funksionale të objektit, duke përcaktuar karakteristikat minimale teknike dhe të performancës që duhet të plotësojnë materialet dhe punimet, pa krijuar kufizime të panevojshme për pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Të gjitha materialet që do të përdoren gjatë realizimit të kontratës duhet të jenë të reja, të papërdorura më parë, të një cilësie të parë dhe në përputhje me standardet shqiptare (SSH), standardet europiane (EN) ose standarde të tjera ndërkombëtare të zbatueshme, si dhe me specifikimet teknike të preventivit dhe kërkesat e projektit.

Punimet do të realizohen në përputhje me:

- specifikimet teknike;
- preventivin;
- termat e referencës;
- kushtet teknike të zbatimit të punimeve të ndërtimit;
- standardet teknike në fuqi;
- legjislacionin shqiptar në fushën e ndërtimit, mbrojtjes në punë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Në hartimin e specifikimeve teknike nuk janë përdorur marka tregtare, emërtime prodhuesish, patente, origjinë, burime specifike ose referime të tjera që favorizojnë apo kufizojnë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë. Në rastet kur, për shkak të natyrës së objektit të

kontratës, është përdorur referimi ndaj një standardi, tipi, marke ose origjine të caktuar, ai duhet të kuptohet gjithmonë i shoqëruar me shprehjen "**ose ekuivalente**", në përputhje me nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se specifikimet teknike janë në përpjesëtim me objektin, natyrën, kompleksitetin dhe vlerën e kontratës, nuk krijojnë pengesa të pajustificuara për konkurrencën dhe garantojnë trajtim të barabartë të të gjithë operatorëve ekonomikë, duke mundësuar për zgjedhjen e ofertës ekonomike më të favorshme në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Njësia e Prokurimit e përbërë nga:

1. **Aurora Shkju**- Specialist Financë (**Përgjegjës Prokurimi**)
2. **Viktor Sheldija**- Drejtor, Inxhinier (**Anëtar**)
3. **Nikoleta Logu**-Specialist Jurist (**Anëtar**)